

A General Survey on *Vepra Pijore* (1907-1946)
(continues from issues 1-2, 2023)

Abstrakt: *Vepra Pijore* was an association of the Catholic Clergy, founded in the Saverian Seminary in Shkodra in 1907. The association was created to serve the propose of publishing and distributing useful works such as calendars, novels, history books, hagiography studies, translation of books on religion etc. Standing for Pious Works, the *Vepra Pijore* formed part of the Albanian National Awakening as it contributed to the national question, to the enriching and purification of the language from Ottoman loans. It also lay the groundwork to the literary Albanian by continually ameliorating phonetics and graphemes used in its publications in time.

The main supporter of the *Vepra Pijore* was the printing press “*Zoja e Papërlyeme*”, in Shkodra.

The foundation of the *Vepra Pijore* was the result of the ceaseless efforts of a group of clergymen who managed to publish a collection of 44 works spanning difficult years in Albanian history. Fr. Shtjefën Zadrima, S.I., creator of such project along with Fr. Francesco Genovizzi, S.I., its founder and several other co-operators and benefactors made possible the publication of such collection, which contributed to Albanian literature, history, archaeology and religion.

Keywords: *Vepra Pijore*, Jesuit Fathers, periodicals, Shkodra, Albanian literature.

Përkthime të dramave e kallximeve të *Veprës Pijore*

Nisur dhe nga qëllimi i programit të *Veprës Pijore* për t’i sjellë lexuesit “do libra ndo librecë literatyret, kallxime historiake t’kishes a të shekullit, libra historijet t’natyrshme, romanza moralishte”¹, po ndalemi te disa prej këtyre përkthimeve. Qëllimi i tyre ishte që letërsia dhe leximi të lidhej me fenë, por edhe të edukonin vlerat te lexuesi, ato që vijnë përmes luftës me

1 “Shoqninat Giûhsore të Rilindjes”, *Leka*, n. 5, 1937, ff. 233-235.

veten dhe njohjes së Zotit si një formë “katarsisi, jo për të treguar fundin pa zgjidhje, por për të gjetur zgjidhje” te një mik i afërt, te fuqia mbështetëse e Zotit si “një lloj skene e humanitetit të thellë dhe e ndihmës estetike për jetën”². Zgjedhja kryesore e temave dhe veprave që përktheheshin e do të përdroreshin në shkolla, “synonte orientimin pedagogjik-didaktik të jezuitëve, kryesisht drejtuar të rinjve”³. Këto libra do t’i shtoheshin letërsisë sonë në fushën e përkthimit dhe më e rëndësishmja ishte se do të përcillej përmes tyre gjuha shqipe te lexuesi. Gjithashtu synonin që të “zhvillonin ndjesinë apo empatinë ndaj fatit tragjik nga pikëpamja e krishterë, pra një faji që mund të bëhej më i vogël”⁴. Përzgjedhja e veprave apo autorëve, sigurisht që kalonte në duart e drejtuesve të shoqatës “t’cillët t’glikojn a është për t’u pelqye landa e librit”⁵, dhe shpesh pjesë të programit u bënë figurat biblike si p.sh.: Gjenovefa e Brabantit, Eustaki, Jozefi, Julja, Joana d’Ark etj.

Vepra Pijore N.1 është një tragjedi me 5 akte, *Sh’ Eustaki o Familia e martirve*⁶. Përveç kujdesit në sprovën e përkthimit, përkthyesi Kolë Thaçi është përpjekur ta ndihmojë lexuesin që në hyrje me shpjegime për grafemat e përdorura dhe me një *fjalor fjalësh më të zorshme*, në faqet e fundit të tragjedisë.

Historia zhvillohet në Romë në shek. II, në kohën e drejtimit të saj prej perandor Trajanit (98 - 117). Tragjedia i kushtohet një figure të njohur pak a shumë në formë legjendare; një të krishteri të devotshëm, i cili përballet me kurajo, forcë e besim të thellë e të vërtetë, përkundrajt besimit pagan të shumicës së njerëzve të kohës. Martiri kristian, emrin e të cilit merr edhe tragjedia, është Shenjt Eustaki, një drejtues i zoti ushtarak i ushtrisë romake, por i dëbuar në malet e Velturinit nga perandori për hir të besimit të tij, larg djemve (Agapiti, Teopisti) dhe bashkëshortes, fatin e të cilëve nuk e di askush. Vonë zbulon se e shoqja ka vdekur si martire e fesë së re të krishterë. Kjo e bën krenar të shoqin dhe fëmijët, edhe pse akoma nuk janë gati ta pranojnë besimin e tyre botërisht.

Rreziku i sulmit të Romës nga barbarët, e shtyn Trajanin të vendosë ta rikthejë sërish Eustakin dhe ta rizgjedhë prijës të ushtrisë së Romës, i bindur në aftësitë ushtarake të Eustakit.

Mbështetje për t’u kthyer Eustaki, u bënë lutjet e Priskut, mikut të mirë

2 M. Peters, *Shtëpia botuese më e vjetër, e Shqipërisë dhe kontributi i saj për Lëvizjen Kombëtare arsimimin dhe kulturën*, Qendra Botuese Shoqata e Jezuitëve, Tiranë, 2016, f. 44.

3 Po aty, f. 124.

4 Po aty, f. 44.

5 *Program i Veprës Pijore*, Leka, n. 4, 1937, ff. 233-235.

6 *Sh’Eustaki o Familia e martirve*, tragjedi me pes hova, *Vepra Pijore*, nr. 1, Shtypshkroja t’Paperlyemes, Shkoder 1909. Përkthyer nga italishtja prej Kol Thaçit, mësues në kolegjin e Sh. Francesk Saverit.

të tij si dhe zëri i ndërgjegjes së vetë perandor Trajanit.

Në kontrast me Priskun, në vepër del Gjani, rival intrigant i Eustakit që “t’rrebtë e lypi ahmarrjen”, e nuk pranon ta shohë të ringritur e me pushtet Eustakin:

“Rrah per tokë metë. E mjeft qi Eustakit
Gaz mos t’i dalë, e mos ta mlojnë lumniya”.

Përmes gojës së Teopistit, djalit të Eustakit, del më në pah figura e Gjanit:

“një fatzi, një i praksuem â Gjani, i kobit
Aj t’on hartues; kshtu ligjirote baba
Mos e mizoni; por i mrapshte â Gjani”⁷.

Gjani bën çmos ta provokojë Eustakin, por e ka të vështirë, pasi Trajani e “çmon nder fatosa” si “mâ besniku”, si “ndëra” e Romës dhe “t’pushtueshmes mretni pshtimi”.

Me nxitjen e Gjanit “shpirt dijekeq e i zi” e prej mashtrimeve të tij, Trajani i kërkon Eustakit që të lutet për fitore te tempulli (në një vend pagan, që nuk i përshtatet besimit kristian të Eustakit):

“Ty templli
T’ngasim me vrep. E si fatos t’dishmohet
I pershpirtëshem Eustaki”.

Eustaki nuk pranon asesi të shkojë në tempull, por kur e sheh se po e detyrojnë, çon duart lart e thërret më zë të lartë “Lumni tye t’kjoftë, o Mret i Jets”, duke pranuar që është i krishterë. Kjo i çon drejt dënimit të tre, babain me djemtë. Eustaki u jep zemër fëmijëve të marrin forcë nën shembullin e nënës martire dhe të frymëzohen prej saj:

“O bir! I shkurtë, i shkurtë, o bir âsht ahti
E psimi, por n’âmshim i naltë gazmëndi”.

Me kurajon që i jep besimi, Eustaki thërret: “mbrini koha/ Qi e verteta t’ushtojnë neper kto vise”.

Drama shoqërohet herë-herë me vallen e korit, e ndërtuar me vargje që rimojnë. Merita e përkthimit të veprës së parë të serisë së botimeve, i takon Kolë Thaçit. Ai ka mundur të sjellë një përkthim të bukur të Filippo Allegro të Albengës, në 11 rrokështa, me një gjuhë të gjallë e të pasuruar për kohën.

Më 2007 studiuesi gjerman Markus W. E. Peters, vlerat tipike gjuhësore të sjelljes në shqip të kësaj vepre melodramatike, i trajton edhe si kulturë personale të Thaçit: “Merita e veçantë e përkthyesit qëndron në faktin që ai e ka shfrytëzuar mirë lirinë e përkthyesit dhe nëpërmjet fjalorit të *rizbuluar* nga ai i shqipes së vjetër dhe të gjuhës moderne shqipe, ka hapur dhe ka bërë të përdorshëm një thesar të ri fjalësh”⁸.

7 Sh’ Eustaki, vep. cit., f. 61.

8 A. Çapaliku, *Përkthimet e Kolë Thaçit, mendimi i M. Peters (2007) për K. Thaçin*, në

Me gjithë vështirësitë e saj si vepër e parë e shoqatës, për nga ana e fjalorit apo edhe e shkrimit të fjalëve, njihet për vlerat e saj gjuhësore, kulturore e letrare.

Botimi i dytë i *Veprës Pijore*, është drama në dy pjesë, *Zefi i njoftun*, me përkthim po të Kolë Thaçit. Kjo dramë bën fjalë për historinë e dy vëllezërve Jozefi dhe Beniamini, marrë nga Dhiata e Vjetër. Jozefi mishëron tipin e njeriut të pafajshëm që vuan, por që lartësohet e shpërblehet nga Perëndia⁹.

Për përkthyesin e saj, Alfred Çapaliku do të shprehet me një vlerësim maksimal në kontekstin kohor kur Thaçi solli përkthimet e para të *Veprës Pijore* në dramaturgji. Vlerësimin e parë e sheh në erudicionin e tij si njohës të gjuhëve të huaja, por dhe për mënyrën inteligjente të përzgjedhjes së veprave që përktheu, pasi "...me vënien në skenë të tragjedisë së Filippo Allegros dhe të melodramës së Pietro Metastasios, e përdori teatrin si një mjet pedagogjik, që i shërbente formimit të nxënësve, si një mjet artistik që i shërbente kulturimit të prindërve të tyre dhe si një mjet moralistik që i shërbente edukimit të spektatorëve të Shkodrës në sallën 450 vendesh të mbushur përherë plot e përplot"¹⁰.

Dy botimet e para të *Veprës*, u botuan me alfabetin e ri të vendosur në Manastir¹¹.

Bardhi e Fernandi tu vorri i Karlit IV. Duka i Agrixhentit (*Vepra Pijore*, n. 3), është një tjetër vepër dramatike, me pesë akte¹². Është përkthyer prej italishtes nga Pashko Gurakuqi, mësues në kolegjin saverian. Në qendër të dramës është historia e marrjes së pushtetit më tradhti e vrasje. Karli IV është duka i Agrixhentit, të cilit i kërcënohet kurora nga Filipi, armiku i tij. Filipi e burgos Karlin IV në një vend të fshehtë dhe të gjithë besojnë se ai ka vdekur. Fernandi, babai i Enrikut dhe vëllai i Bardhit, kthehet nga lufta për të marrë në duar kurorën prej Filipit.

Akti i parë hapet me një treme (hajat, sallë) me karrige mermeri në Agrixhent. Filipi "nji shqytaar i t'perndritshmit duke t'Mesinës", pas vdekjes së zotërisë së tij Karli, duke përdorur Enrikun, djalin e Fernandit, kërkon të marrë pushtetin e Mesinës dhe Agrixhentos si "grabitçuer i prujtë". Fernandi 35-vjeçar, pasi ka luftuar në shumë vise e ka treguar virtytet e tij, kthehet në vend dhe mëson që me tradhëti, Filipi i degdisi të atin, Karlin IV në një burg të tmerrshëm dhe mashtroi të vëllain e tij Bardhin 18-vjeçar.

Buletini shkencor, Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", Viti XLIX i botimit, nr. 69, Shkodër, 2019, f. 127.

9 M. Peters, *vep. cit.* f. 126.

10 A. Çapaliku, *vep. cit.*, f. 130.

11 M. Peters, *vep. cit.* f. 125.

12 *Bardhi e Fernandi tu vorri i Karlit IV. Duka i Agrixhentit*: dramë me pesë hova, Shkoder, Shtypshkroje t'Zojës Paperlyeme, 1910.

Pas mundimesh e sakrificash prej intrigave, Fernandi arrin të shpëtojë kurorën dhe dukën.

Drama mbyllet me fjalët e dukës Karl: “A jam ûne m’mjedis t’ birve mûi? O qiellë, o qiellë! Kjo jet’ është dhantija e yte e mrekullueshme edhe ne ma marsh jeten n’ket ças, ani se mjeft kam gjallitë”. Në fund kemi triumfin e së mirës dhe kthimin e kurorës në duart e tij bashkë me djemtë.

Në këtë përkthim ka disa ndryshime nga vepra origjinale të përcjella pa ngatërresa e me një dorë të kujdesshme: emrat e personazheve (Bianka, motra e Fernandos, bëhet Bardhi, emër djali); titulli i ndryshuar¹³, apo dhe te ngjarjet deri diku (Enriku është djali i Biankës në original dhe jo i Fernandit). Ndryshimet nga origjinali e shtyjnë përkthyesin të ndryshojë edhe diçka nga historia, duke sjellë një përkthim sa më afër lexuesit shqiptar të atyre viteve. Për këtë arsye e të tjera, ndonjë skenë edhe hiqet (p.sh. akti i parë, ka dy skena më pak; ndonjë personazh mund të shtohet; nga 127 faqe në original, kemi 94 faqe të përkthyer), ndryshime që nuk e rëndojnë veprën dhe nuk ia humbasin asaj qëllimin kryesor për të çuar në vend misionin e Fernandit.

Gjuha e përdorur është e bukur dhe plot fantazi, në kërkim të përzgjedhjes së fjalëve të duhura në shqipen e shkruar. Hovi (akti) i katërt nis me një përshkrim të burgut ku është kallur duka Karl. Zgjedhja e fjalëve në këtë përshkrim, ndihmon për t’i ardhur pranë dhimbjes së Fernandit që rigjen të atin në kushte të mjerueshme: “Llagore e mneershme e e terrshme bree prejë vjetrimit. Shtylla e qemeer gjysa t’rrenuem, me shkrepë t’ rrxuem, rreshtue n’mëndyrë qi me trajtue do neltsina t’vaditshme; nder âna kan me kënë do t’sjellme t’kthellta. Kjò dukë do t’ngulisin një tmeer t’mâdhe. N’ baall një shkallë t’ gjânë e t’shkurtë, e n’krye t’sajë një derë hekurit, i vetmi t’hûim e t’dalun i atî vëndit.”¹⁴

Vepra ka plot fjalë e shprehje që është mirë t’i rendisë për kënaqësi të shqipes të atyre viteve: *hova, duka, treme, sqelë, i brumlluem, me zbrûe, tui vrumulisë*, apo edhe shprehje si: *ktû due me i pushue briit, shuke zânin, një ftyrë t’vran’ e t’terrtueme, ti mâa s’gjallitë, mbas ktyne vrrimeve u terrnita prejë shum zâneve t’ kobta, nuk baarin tinzime, shpatat t’ona ferfelitshin nder rreze t’ diellit, kiske ballsue deken, paa e zorittë fort vedin, m’a kaa pervneer zêmren, per shka zotnoj është dhântija e zêmrimin t’êm e jo e fatit, t’ duhet m’e ndjekë shtegun n’ te cillin t’ kaa rrshanitë praksimi i nierzve, kputi ato fjalë etj.*

Fjalët e Fernandit drejtuar vëllait që ndihet fajtor, janë një mesazh i fortë dhe i domosdoshmëm për çdokënd në çdo kohë: “N’paç, gabue, tesh kee

13 Placido Maria Visaj, *Bianca e Fernando alla tomba di Carlo IV Duca d’ Agrigento*, Milano, 1830.

14 Placido Maria Visaj, *Bardhi e Fernandi tu vorri i Karlit IV. Duka i Agrixhentit*: dramë me pes hova, Shkoder, Shtypshkroje t’Zojës Paperlyeme, 1910, f. 60.

raa n'pëndim: praa hiq mos druej. Faji e gabimi janë për t'dekshmit marë. Fajtori krenaar meriton me kë në perbuzë prejë nierzve e prejë qiellës, por aj qi e njef fajin e pëndohet, është i dëjë me pasë prejë qiellët e prejë nierzve perdlimin e lipsiin"¹⁵. Faji dhe pendimi janë dy fjalët kyçe të veprës, dhe ajo merr rëndësi për mesazhin që jep të lexuesi, pasi njeriu nuk mund të jetë perfekt e i pagabueshëm, por nëse qëllimet e tij nuk janë të gabuara, e nëse di të pendohet, ai meriton faljen e pranimit nga të tjerët.

*Dyy Pasqyra*¹⁶ i përket *Veprës Pijore* n. 15, në të cilën përfshihen dy *kallxime* apo pasqyra, të autorit Gjon Schoepfi. E para pasqyrë titullohet *Julja*, me shqipërim të Anton M. Xanonit S. J. dhe e dyta *Federiku*¹⁷ me shqipërim të D. Nikoll Kimzës.

Pasqyra e parë, *Julja*, është një histori dashurie për jetën e vërtetë. Dhimbjet e humbjet në të, davariten dhe e lehtësojnë shpirtin e lexuesit, pasi shihen si pjesë e jetës me sakrifica, në përballje me të keqen. Julja, vajza e Izaut (senator i Kartagjenës), i jep emrin veprës, pasi ajo shihet si modeli i njeriut me moral e besim, që i bën ballë çdo sakrifice. Ajo edhe dënimin në kryq e sheh si një "shkallë m'u njitë n'lumnii t'pasosme", "e madje gazmote pse e merthyemun m'at kryq i pergjate Shelbuesit t'vet krygjzue për të" (f. 71). Shprehëse më e mirë e besimit të saj, bëhet mikja Maksime e cila thotë: *Atà e kan çaa deetin anë m'anë nen hije t'Naltit Zot ... shtylla e barkës s'tyne kaa kë në kryqi, rremat e tyne dashtnia, spiranca e tyne shpresa; atà kan pshtue, do t'pshtojm edhè na.* (f. 30)

Ngjarjet zhvillohen në vitin 439 pas Krishtit (fillojnë një natë vjeshte të atij viti), ndërmjet Kartagjenës (Kartagut), qytet i Afrikës "fort t'permëndun asò heret", Sicilisë dhe Korsikës, ku këtë të fundit e drejtonte atë kohë, kundërshtari i betuar i besimit kristian Gjenseriku.¹⁸ Skena e parë hapet në brigjet e Kartagjenës me urdhërimin e "Gjenserikut, rregjit Arjan" me larguar Ipeshkvin me gjithë priftërinjtë nga Kartagjena e me i hedh me lundra në det të hapur "t'hupshin nd'uj"¹⁹.

Euzebi është personazhi i parë që prezantohet. Ishte kartagjenas, tregtar shumë i pasur i mëndafshit, 25 vjeç, i gjatë, i pashëm, i begatë nga shpirti, i ditur nga mësimet e fituara prej udhëtimeve sidomos në Athinë e Romë. Prindërit i kishin vdekur shpejt, por pare "i kishin lânë saa gadi mos m'u njehë" dhe e shihte jetën si fushë me lule. Bie në dashuri me Juljan dhe lufton deri në fund për ta fituar dashurinë e saj. Julja ishte një vajzë

15 Po aty f. 82.

16 Gjon Schoepfi, *Dyy Pasqyra*, e dyta dorë, Shtyp. e Zojës s'Paperlyeme, Shkoder, 1915, *Vepra Pijore* nr. 15.

17 Kjo pasqyrë është botuar fillimisht në *Kalendarin* e 1915-ës dhe në përshkrimin e atij kalendari është folur rreth kësaj pasqyre.

18 Genserico apo Gaiseric (389-477).

19 *Dyy Pasqyra*, vep. cit., f. 8.

e devotshme në besimin kristian. Ajo e refuzon dashurinë e Euzebit, pasi pengesë për këtë lidhje është besimi i tij pagan. Ajo nuk njeh dashuri tjetër veç Zotit dhe është kjo dashuri që i jep forcë edhe kur e shesin si skllave, edhe kur e trajtojnë si të tillë në punët më të rënda.

Kur Euzebi merr vesh prej Jadbës, shërbëtorit besnik, se Julja dhe i ati shiten si skllavër, vrapon për ta shpëtuar atë. Julja fiton lirinë në sajë të pasanikut Euzeb, ndërsa Izau, senatori i Kartagut, babai i Juljas, bie rob në dorë të Gjensërikut, mbretit të Vandalëve, në Korsikë. Për hir të dashurisë që ka për Julian, Euzebi rrezikon jetën që ta shpëtojë Izaun, por përsëri kjo sakrificë nuk ndihmon dhe vepra mbyllet me tragjedi. Pengesat në vepër nuk mungojnë. Jabde, si një *Sinon* historik që kërkon të hakmerret për t'i "shpëtuar" skllavërisë së tij, bëhet shkak i prishjes së kësaj lidhjeje në mënyrë tragjike. Ai është "kali i drunjte" i kësaj historie.

Në fund Julja kryqëzohet nga idhujtarët e perëndisë së Bakut dhe vdes në duart e njerëzve që e deshën më shumë. Ata, Euzebi, Izau dhe Maksimja e mbyllën jetën si kristianë, në ishullin e Margeritës (Gorgona e sotme) "qi i rri Livornit kundrruell", aty ku prehej edhe trupi i Juljas. Forca e besimit të Juljas, ndryshon zhvillimet e ngjarjes, dhe mirësia e saj bëhet drejtësi për të tjerët.

Julja, një martire e virgjër, kristiane e betuar, të mbush me forcë e besim dhe të jep shpresë se jeta nuk është e lehtë, por e bukur dhe me gjëra që mbesin pas. Ajo na mëson se çfarë do të thotë të lësh gjurmë. Siç thotë dhe i ati i saj në fund të veprës, me vdekjen e saj si besimtare, i "kaa prîi para n'lumnii t'qiellve" (f. 74). Vepra nuk është vetëm vepra e dashurisë për Zotin, por e dashurisë për njeriun që e do jetën me të mirën e saj pa të keq. Ajo të frymëzon me modelet që përcjell; modelet e një Shën Francesku, apo e një shën Marie që si njerëz, e deshën veç të vërtetën ndër njerëz të tjerë.

Disa nga fjalët e shprehjet që mund të përmendim në vepër për bukurinë e tyre janë: *barshin ngrykë foshnjët e veta; n'fityrë t'gjithve u dukte pikllim i foort; nji e paame jau suell t'gjithve shikjimin m'njen' anë e s'la zëmer paa u tundë; me manga deri tu noga e dorës; e njeshun briish me brëz t'gjânë; i daajte n'fityrë dija e shëjtnia; tuj e shtii kâmen n'lunder; kah u bate kjo punë; eera e jugut i tretëte lundrat lerg e lerg, saa mos me i daa mâ sÿni; buunar; i lecuem si lisi, qi e kaa shkundë boren prej degësh; me t'bâa sÿyt ylber; me m'a lecue rangen, qi m'a pershpiirti zotnia; me ja vûu menden; hyjt gaxullojshin n'kupë t'qiells; i giate hânës, qi naten e shetitëkândshem e madhnisht kupen e qiills; po mihte nd' ujë; me rrahë me mënd; msallë me dyy faqe; porositi ate m'saa driten e sÿnit; kaa me t'a prûu marë; me pii ujë t'freskët te prroni i malit, qi balxote mii shkam e prej shkamit tuj ndeshë guur m'guur bite perteposhtë; tuj ja thekë kâmve, m'nji sahât rrugë i diktoj; luhti arma n't"dyjat anë me gjak t'xeet; e shihte shtegun e jetes s'vet shtrue me lule.*

Disa nga fjalët në tekst, përkthyesi i shoqëron me fjalë sinonimike si

shpjegim në kllapa:

treme – hajat;
portik – vend me strehë persypri e i sillet rreth ndoj Saraji;
gajther – vënd i neltë;
tortungel – mishthiut;
krajata – halle;
mllef – maraz;
pyrgu – kulla;
tari – rasa;
karavë – barkë e madhe;
lerdh – shermashëk;
patalok – shesh;
i shkerdhyet – i flligët;
ja kena true – ja kena shugurue;
arsenala – vend ku ndertohen a ruhen aniit, armët e vegla luftet.

Vepra dallon për gjuhën e saj dhe Xanoni e ka treguar vlerën e tij në këtë mundim për ta sjellë sa më bukur shqip.

Një roman vetjak dhe një jetëshkrim

Pushka e trathtarit (rromanz historjak Shqypnijet, *perbâa prej Zef M. Harapit, Shkoder 1914*), është botuar tek *Vepra Pijore* n. 14. Ky roman është një krijim tërësisht vetjak. Tema që trajtohet në vepër është hakmarrja, gjakmarrja dhe jeta tejet e vështirë e malësorëve. Romani tregon gjendjen e mjerë e të varfër të atyre viseve shqiptare, ku fëmija sa hedh shtat e pa iu pjekë ashti, bëhet bari, ku burri punon për të mbajt familjen e gruaja (në malet tona), punon më shumë se një trim. Historia nis me një përshkrim të natës, të mbylljes së plotë të çdo shenje jete brenda mureve, në paralelizëm me dhimbjen e një nëne (Lula) që ofshan në varrin e djalit të saj Lekë Prendit, vrarë për hakmarrje.

Lula mes këtyre maleve, në fshatin Shas kishte luftuar t'i rriste jetimët e saj: vajzën Prende, Lekën që ia vrau malazezi dhe Marashin që i ati ia kishte lënë 6 muajsh e ia rrëmbyen nga djepja. E vetmuar, pa përkrahje e në dëshpërim, Lula kërkon shpëtim te Don Pali i Shkodrës, te Ipeshkvi, te fqinjët e mirë, te njerëzit që aty rreth jetës së saj, vënë dorën në zemër. Dy muaj më parë ishte nëna e dy djemve, e tani e mjera nënë nuk ka asnjërin pranë.

Drama e familjes nga Lula, vijon me Prendën, vajzën e saj, që e vetme në Shas, shihet si karrem i lehtë për gjakësit e të vëllait. Sjellja e saj diku përçmohet: “kaa thënë i moçmi: shaka kuer t'losë bishtin, i vëhen qêt mrapa”, e diku mbrohet; Mark Gjeloši, fqinji i Prendes dhe i Lules e mbrojtiti atë me jetën e tij dhe djalit Mhill. Vata, djali tjetër i Markut bie në dashuri me Prenden, por rrugët e tyre ndahen; vajzën e fejuan në Shllak me Gjonin.

Autori akuzon për fejesat e vajzave në malësi, se fajin "...shum herna e kan maa s'fortit njata qi e martojn tuj baa n'asgjâa njat lirii t'arsyeshme qi kan djali e vajza me zgiedhë me urtii fatin, me t'cillin, jo ata qi e napin, por vetë do t'rriin e do t'jetojn deri n'fill t'mordes²⁰". Jeta e saj kalon në peripeci historish të njohura; ajo është *Bardha e Temalit, Zoga e Mjedës* apo shembuj të tjerë që letërsia jonë i ka bërë të njohura. Historia e Prendë Lek Vuksanit nga Shasi, nuk është historia e vetme e atyre zonave.

Historia e këtij romani duhet parë në të dyja aspektet që autori jo më kot i sjell ndarazi: historinë tonë të lavdishme, të lashtë e plot sakrifica dhe nga ana tjetër dramën e varfërisë sonë ekonomike, por disi edhe mendore. Të dhemb kur sheh sa pasuri shpirtërore e dashuri për tjetrin ka njeriu i vuajtur, kur sheh një nënë që ofshan në varrin e djalit të saj, me një këngë vaji tepër prekëse, me një fjalor dhimbjeje të përplotësuar! Sa dashuri e besim për Zotin! I luten e pranojnë vullnesën e tij pa kundërshtuar e pa u dorëzuar. Lula i thotë së bijës "Nji amanet po t'a llaa oj bii, edhë n'deksha t'a lypsha n'at jetë: mos me e lshue uraten doret, mos me e harrue Atë, qi i kjoshim falë...". Kjo loke e vuajtur shqiptare e maleve, thotë në fund të librit "m'ka sprovue Zoti me gjithfarësh, por atij t'Lumit i kjoshin falë, e vullndesa e Tii u bâftë".

Ngjarja që rrëfëhet në kufirin e 30 viteve, mbyllet me një fund disi të lumtur, me kthimin te Lula të djalit të rrëmbyer në vegjëli.

Zëri i autorit mbi problemet shqiptare e sidomos për gjakmarrjen dhe hakmarrjen del në gojën e një gruaje të moshuar që ndihmon familjen e Lules hallemadhe: "Punë t'pamira, pasha buken; e kush? I kshtëni me t'kshtënë, mo Zot maa keq! Kto punë s'm'i kânde mue aspak, jo... E deri kuer maa kan me shkue giatë Shqyptarët e shkretë tuj fikë vedin e shpiin e vendin me gjaksiina...? A s'kaa me lee kurr per nee dita e nji rahatis t'vertetë?²¹"

Llojin letrar *Rromanz historjak Shqypnijet*, vepra e merr që në fillim të saj, pasi autori sjell materialin historik në vepër, bazuar në të vërteta të dokumentuara e jo trillime. Duket si një kronikë që shkëputet herë-herë nga historia e Lules dhe familjes së saj. Përveç kishave të vjetra që përshkruhen në fillim të romanit, flitet: për koncilet dhe ipeshkëvitë që nga fillimet e tyre, për historinë e Shqipërisë që nga koha e Gentit e deri në rënien në duart e otomanëve, për historitë e ndërtimeve të vjetra, për kishën e Zojës dhe Sh' Njonit të Shasit etj. Autori arrin të na përcjellë edhe disa problematika të tjera të kohës, siç është mungesa e kishave dhe shërbesat fetare në shtëpi. Kohë e vështirë kjo për vendin tonë "me i krye shartet e Fees", problem që "ankon qysh n'vjet 1702 "Konçili I i Dheut t'Shqypniis" dhe vetëm "dhânmbja e Sakramêndeve u lypshin me e vûu per rrugë t'praksuemin e me e prûu n'fie t'keqin qi mjerisht u shtyete shpesh e shpesh deri te t'lshuemit e Fess

20 *Pushka e trathtarit, vep. cit., f. 164.*

21 *Po aty, f. 124.*

t'moçme qi Skanderbegu e t'parët t'onë e kishin pasë ruejtun e dishmue per saa e saa qinda vjet para se t'a ndrroishin..."²². Në nyen XXIII flet edhe "per Tivaar, qi tash me disaa vënde tjera t'Shqypniis e kan n'dorë e zbukurue Malazezët, po na kânde n'ket nye me qitë një shkurtore historjak permii Malzii tuj diftue se si e kuer kjë mkamë kjò krajlnii e vogel qi kena per brîi". Kështu flet për kohën që nga Stefan Dushani në vitin 1346, te Pjetri II "qi duel kso jetet vjeten 1751, e u daa n'shëj n'lame t'poeziis me liber qi pat: *Gorski Vijenac*"²³ e deri te Knjaz Nikolla "nen t'cillin u bane luftat e mrame me Turk qi vluene per 15 vjet deri saa u bâa pagja me 31 kallnuer 1878". Autori, në përshkrimin e varreve në Koman, duke cituar edhe Legrande-n si studiuesin e tyre, numëron objektet që janë dërguar në "Musée National Saint German të Parisit", objekte që ngjasojnë me disa të tilla, zbuluar në Bosnjë, për të dokumentuar shtrirjen e kombit tonë.

Në roman përveç të dhënave e fakteve historike, jepen edhe disa zakone e doke, si dhe analizohet psikologjia e banorëve të zonës së Shasit, mënyra e të jetuarit, se si e lidhin jetën me mitologjinë apo bestytinë. Fjalët *kori*, e *marre* janë fjalë që ndeshen shpesh dhe që përcaktojnë psikologjinë e atyre banorëve. Po ashtu të pakuptueshme janë dhe arsyet që i shtyjnë të "çojnë" armët kundër njëri-tjetrit. Jeta e tyre dhe pse tre orë larg Shkodrës, ishte gati primitive.

Çdo rresht rrjedh në të lexuar prej gjuhës së përdorur me një fjalor termash të kohës që sot e kanë humbur përdorimin, por që të bëjnë të shijosh në çdo fjalë shqipen.

Në kopertinën e fundit të revistës "Përparimi", janar 1915, Atë Shtjefën Gjeçovi shprehet me vlerësime për librin që sapo i ra në dorë e lexoi "... fillim e marim. – I lumët dora Z. Zef. M. Harapit, i cilli, - si e dishmon libri – me kujdes por edhe me mûund t'madh e paska mledhë lânden e librit. Libri m'âsht pelqye, e aq m'kaa knaqë, qi s'muejta me e hjekë durësh paa e paa marimin e pûnës. Kahë kallximi i ndollniës âsht i dhimshem, kahë gjaksia âsht i mneershem, e kahë historia âsht i dobiëshem. Si m'knaqi mue, kam shpresë se edhe vllazen t'onë Shqyptarë kan me e blee paa kursim, e si t'a kndojnë kan me metë t'knaqun! - A. S. K. GJEÇOV O.F.M."

Nën titullin "Jetëshkrimet e shenjtërve" nga italishtja vjen përkthimi i Gjeçovit me titullin "Joana d'Ark", një jetëshkrim që vliente si vepër analoge për luftën e shqiptarëve kundër turqve e në fjalën e tij në parathënie Atë Gjeçovi lutet që Jeanne d'Arc të ndihmojë shqiptarët e Shqipërinë e mbuluar me errësirë²⁴.

22 *Pushka e trathtarit*, vep. cit., f. 52.

23 Shih: Petër Petroviq-Njegosh, *Kunora e maleve*, përktheu nga serbishtja E. Mekuli e Z. Nekaj, Prishtinë 1952.

24 M. Peters, vep. cit., f. 125.

Shujtat e Veprës Pijore

Do libra tjerë të Veprës Pijore, janë edhe librat e fesë (Libra Fejet). Libri i uratave apo shujtja shpirtërore është doracak që shërben si ushqim shpirtëror, një lloj visari qiellor që me anë të lutjeve ndihmon marrëdhënien mes trupit dhe shpirtit. Këta librecë janë botuar herë pas herë nga *Vepra Pijore*, duke u përpunuar e përmirësuar (ribotimi i tyre i përpunuar sipas kërkesave të kohës dhe të besimtarëve: e para dorë, e dyta dorë deri dhe e pesta dorë). Shujta apo Libri i lutjeve, me këngë për raste të ndryshme fillon në vitin 1912 me botimin e *Uratë t'perditçme e do t'lutuna tiera* (Vepra Pijore, n. 7) e pastaj *Shyhreti i Divoçem* (e treta dorë e shtueme, Vepra Pijore, n. 8); më 1924 *Uratë t'perditçme e do t'lutuna tiera* (e dyta dorë, Vepra Pijore, n. 34); më 1919 *Shyhreti i divoçem* (e katërta dorë e shtueme, Vepra Pijore, n. 24), më 1932 vjen me ndryshim emri *Kangë të divoçme* (e pesta dorë, Vepra Pijore përsëri n. 24²⁵).

*Shyhreti*²⁶ i *Divoçem*²⁷ (e treta dorë e shtueme, Vepra Pijore, n. 8), botuar në 1912 në shtypshkronjën e Zojës s'Papërlyeme përmban gjithsej 111 faqe. Në përmbajtjen e saj (*Perkreica*), rreshtohen këto të dhëna:

1. Kangë Misionesh;
2. Pûnët e Pendimit;
3. Para Kungimit;
4. Mbas Kungimit;
5. Kangë per t'kreeme t'mëdhaa;
6. Kangë n'lavd t'Jezu Krishtit;
7. Kangë n'lavd t'Zojës s'Bekueme;
8. Kangë n'lavd t' Shêitnave.

Ajo hapet me një lutje si “Kangë Misionesh” me thirrjen *Kioftë bekue Zoti* dhe vijon faqja e dytë me “Fjalët e Misionarit n'fillim t'Misionit” fjalë tepër të bukura në forcën thirrëse të tyre, fjalë plot poezi: “Zoti vetë, o i kështenë, m'kaa çue/ Fialë shëlbimit me t diftue;/ Por mos t'jet' e mramia herë/ Qi do Zoti me t'bâa ndeer”. Një misionar që e pret një rrugë e gjatë sakrificash, shprehet me forcë përmes fjalës së “Zotit, qi a gjith dashtnii”, “qi pa prâa/ t'bân me e ndie t'amlin zâa” duke shkuar në atë mision plot mundime që “s'kaa kurr per t'pas marim”. Në fjalët e zgjedhura në lutje, gjën veten çdokush: “Me pasë gjithçka dishron, e ç'ka â n'dyrnjâa,/ N'e bierrsh tî shpiirtin tand ça t'viijn?/ Kurr gjâa!//”.

Te këngë pendimi, “Eja, eja o dashtenii”, mjaft peshë marrin vargjet e

25 Kjo vepër del përsëri me n. 24, sqarim që është bërë në pjesën e parë të këtij kontributi tonë, tek lista e plotë.

26 fama

27 *Shyhreti i Divoçem*, Vepra Pijore nr. 8, Shtypshkroje “Zojës s'Paperlyeme”, Shkoder 1912.

fundit:

*Eja, gëzimi i jëm maa i ploti,
O zamaku sall shyhret;
I Mariis, i biri e Zoti
Eja n'zëmër, qi po t'thrret.*

*Gjith u dogja, gjith u shkrîna,
Zëmren maa, s'und po e zaptoi;
Ngrykë me t'mârrun ngutshem m'rrîna,
Qe po vi, qe po flutroi.*

*Porsí shûita fort etshue
N'dashnii t'ânde shêite theer,
Po dihati tui shpeitue
M'u bâa bashkë me tyy gjith herë.*

Disa prej këngëve që mund t'i përmendim, janë:

1. Zojës s' 'paperlyeme (Na po t'falna, po t'falna o Marii;/ E Kshtênimit lumnija ti jee;/ Neper mal, neper fusha, n'Shqypnii/ me një zëmer bashkona a me 'i fee!²⁸⁾
2. Kraljica (Ti jee kroni i amelcimit,/ Ti zamaku jee i pastrimit,/ N'vepra t'mira me na ndjeke,/ E n'pastrii na bân me deke.²⁹⁾
3. Zojës s' Shkodres, që i kërkojnë mëshirë, të kthehet e të ndihmojë Shkodrën si nënë e të parëve, duke i kërkuar mëshirë për vete e mëshirë për Shqipërinë mbarë³⁰⁾, "rreth e rreth fugurës s'ate,/ kaa mu mledhë gjith Shqypitarija".
4. Zojës Cernagore (Gëzou, Shqypnii, Shqypnii fatmadhe,/ Qi prej qiellit pate baftin/ Këjo farë Zoje me ngulë taftin/ N'tyy me t'prue e me t'dalë zot.³¹⁾ etj.

Lidhur me pjesën e këngëve kushtuar shenjtërve, ka këngë për:

1. Shën Jozefin;
2. Shën Luigjin;
3. Shën Mihillin;
4. Shën Koollin;
5. Shën Njergjin;
6. Shna Rrokun;
7. Shna Prenden;
8. Shna Ndoun- etj., duke u mbyllur me
9. "Këngën e Papës".

28 Po aty, f. 61.

29 Po aty, f. 62.

30 Po aty, f. 70.

31 Po aty, f. 71.

Në të gjitha këto këngë, jepet përmes vargjeve rrugëtimi i tyre i vështirë dhe përkushtimi ndaj Zotit.

Po sjellim këtu të plotë, njëren prej tyre:

Sh' Njergjit³²

*Ishte Sh' Njergji i parë n'ushtrii
T'Dioklecianit asò kohet,
Kuer nji e madhe kundershtii
Kundra fejet qe po zblohet.*

*Tui mendue shkote per dit:
Un qi i parë e i madh jam, thote,
Viin Feen t'ême n'pah m'e qitë,
Jo m'e mlue per ket frigë kote.*

*Zêmer veedit kështû tui i dhanë,
Filloi para m'u gatue,
Me ju bâa Krishtit kurbân,
Dashtenin per me i diftue.*

*Gjâan e mallain t'gjith e shet;
E per veedi kurgjâa s'ndali:
I hoq petkat shtatit t'vet,
Fukaraave t'tânë jau fali.*

*N'sarai t'krailit nji ditë shkon
At katil per m'e qortue;
Krail, i thotë, fort po gabon,
T'kështênët paa fai jee tui i mundue.*

*Fort at herë kië kundra tii
Pezmatue krail Diokleciani
E praa, it ha, çka t'jenë mâa zii,
Do xhelatve, mbîi tê bâni.*

*Si ja grîine mishin t'tânë
E me goozhda ja shporuene,
T'shkretin Gjergj paa frÿm' e lân,
E se kish marue kuituene.*

32 Po aty, ff. 95-98.

*Kuer n'e nesre shkuen me paa,
E kuer shëndosh e mir' e gjetne,
Si me kënë n'anderr ju bâa
T'tân' habit, mrekillue metne.*

*Per ket t'madhe mrekillii
Diokleciani kië terbue:
Per m'e mûitun feen e tii
Prep urdhnoi t'shkrenë m'e mundue.*

*M'e diegë Gjergjin n'zierm e shtëjnë
Edhë e qitne mrëndë n'gerqe
Tui e rrahë mishin ja grîjnë,
Shtaan ja bane fele fele.*

*Sabri i madh qi at ditë diftoi,
Shûm t'patee bâni m'u këthye;
Deer xhelati, qi e mundoi
Filloi Zotit me i sherbye.*

*Lypi Gjergji n'kishë me shkue
Kû t'pafeet putat adhroishin;
T'parët urdhnuen praa at herë m'e çue:
J'â këthye mendia Gjergjit, thishin.*

*Por saa mrendë n'at kishë hîi.
N'vend qi idhuit me adhrue,
S'mundi jû, tha, shpiirtna t'këqii,
Para t'kështênit me qibdrue!*

*Kuer këto fialë Sh' Njergji pat thanë,
E kuer shêjin e krygjës bâni,
Gjimoi kisha per gjith ânë
Nji brimës t'mneershme ju ndîi zâni.*

*M'at ças idhuit t'tanë per dhe
T'gjith i paane kah' u rrxuene,
Shndritë nder mend shûm nder t'pafee
M'Jezu Krishtin Zot besuene.*

*Diokleciani por sa ndien
Se kështû Gjergji kish pûnue,*

*T'shkretit kryet me'i herë ja preu,
Paa e mytë s'muiti m'u durue.*

*N'Shkoder t'onë Sh' Njergji i rii
Lutet fort; t'tanë punët fillohen
N'javë t'këti Shëit: shegerta t'tii
Mârrin mieshtrat, shpijat ndrrohen.*

*Mrekulli Sh' Njergji paa prâa
Bân: n'rreziqe shum vetë ruiti;
Edhë nee na ndîmoftë praa
Me muit diallin si ky e mûiti.*

Kangë të divoçme (e pesta dorë, 1932³³, Vepra Pijore, n. 24), libër i vogël xhepi me përmasa 15x10 cm, vjen me disa ndryshime siç thuhet në parathënie: “Mbas tash sa vjet botimi i katert i librecit *Shyhreti i Divoçem* është sosë mendueme me ja u çue dishirin në vend sa e save qi na e lypshin tuj bâ një botim të rî. Në ket botim, përposë titullit kena ndrrue, aty ktû, edhe ndo'i kangë, qi kishte tepër fjalë të huajsh, por ndrrime të mdhâ s'kena bâ, pse një shumicë e madhe e popullit kto kangë i din përmëç. Ky mûnd i vogël i ynë kjoftë per mâ të madhen lumnin e Tenzot, per land të Zojës së Bekueme e të Shëjtenve, në nderë të cileve kndohen kto kangë.”

Përmbajtja e këngëve jepet në fund si *Diftojsi*, në ndryshim nga *Perkreica* që është përdorur në botimet e mëparshme. Ka një organizim më të mirë të tyre, siç theksohet te diftojsi për *Kangë tjerë per kshndella* “kndej e mbrapa, në setëicillen kaptinë, fillesat e kangve rreshtohen alfabetikisht”. Gjithashtu lidhur me këngët kushtuar shenjtërve, mungojnë këngët: Shën Mihillit, Shën Njergjit, Shna Rrokut dhe Shna Prendes.

Te *Kangë të Divoçme* (1932), në *kaptinën e Shëjtenve*³⁴ gjenden këngë kushtuar:

1. Sh' Jozefit;
2. Ejllit të Rojes;
3. Sh' Prosperit Martir;
4. Shëjtit Shen Koll;
5. *Jesu, Redemptor hominum* (me shënimin – ky hymn kndohet në nderë të Shen Kollit por i përshtatet edhe cillitdo shëjtit Ipeshkev);
6. Shna Ndout;
7. *Infensus hostis gloriae*.

33 *Kangë të divoçme* : e pesta dorë, shtypshkronja “Zoja e Papërlyeme” Shkoder, 1932.

34 Po aty, f. 92.

Disa ndryshime të vogla vihen re edhe brenda këngës.
p.sh.:

Mendime per Misione (nga Shyhreti,
1912, f. 7)

*E ti, qi me dekë mir'as kurr
s'mendon,
Shikiò qi mâa se 'i herë me dekë
s'qillon*

*Kush s'di se saa kushton ç'do i zii
lezet
N'fund t'ferrit t'shkoin m'e këqyrin
me sýy t'vet.*

*Me raa atý poshtë një herë ne
kamba t'lot,
Ah! kujtò mirë, pse s'del saa â Zoti
Zot.*

Mendime per Misione (nga Kangë,
1932, f. 12-13)

*E ti, qi me dekë mirë se kurr
s'mendon,
Shikjò se mâ se 'i herë me dekë
s'qillon*

*Kush s'di se sa kushton një qëf i zi,
Në fund të ferrit të shkojnë: atý
mirë ka m'e ndi.*

*Me râ atý poshtë një herë në kje se
don sot,
Ah! mendò mirë, pse s'del sa â Zoti
Zot.*

Ndryshimet janë në përmirësimin e aspektit leksikor, për ta përmbushur edhe më mirë dëshirën apo mendimin e duhur, apo siç është thënë në parathënien e librecit, *për ta sjellë fjalën më shqip*. Te *Kënga e Papës*, zëvendësohen fjalët e huaja p.sh. *veqil* në librecin e 1912, ndryshohet me fjalën *xêvendsi*. Po ashtu përmirësohet mënyra e të shprehurit të mendimit. P.sh. te kënga *Zoja Karmë*, vargu “*prei ndîmes t'ate keq s'kaa paa*”, ndryshohet me “*ndima e jote pshtuem e ká*”, apo vargu “*Bânu, amân! ti hyll medetit*” ndryshohet me “*Hýll, deh! bâniu njero-shkretit*”.

“Kangë n'lavd t'Jezu Krishtit”
(Shyhreti, 1912, f. 49):

Tyy po t'falem

*Tyy po tfalem, o Dashtnî
M'a ndrro zêmren gjithunjî:
T'gjith aletet ti shêitnoi,
Ti m'i ruei qi mos t'mkatnoi.*

“Të lumit Jezu Krisht” (Kangë,
1932, f. 71):

Jezu Krisht, ti jë i mirë

.....
*Tý po tfalem, o Dashtnî,
M'a ndrro zêmren gjithnji:
T'gjitha shiset t'i shêjtnoj,
Bân, o Zot, qi mos të mkatnoj.*

Këngametitull “*Djelte Shqypnis*”³⁵, meshënimin, hymni Kongregacioneve *Mariane*, tregon lidhjet e forta të besimit me atdheadashurinë në edukimin e rinisë.

35 Po aty, ff. 73-74.

Djelt e Shqypnis fisnike
Sot i bashkon dashtënjia, nder ta perherë vllaznija
Krej shëjte tash mbretnon

.....

Jem të ri, por kah vertyti
Kush hovin s'mund të n'a ndalin.
Tuej ndjekun idealin
E atdheut qi s'do të mbarojnë.

Rubrika apo kaptina e fundit është *Dý sende qi do të kém per zëmer*. Poshtë këtij emërtimi është vënë një sqarim: “Po na kande m’e mbyllë ket librec me dý kangë të cilat kndojnë dy sende qi do të kém fort për zëmër: Fen, e Shëjtin Atë Papë. Kanga e parë (e xjerrun prej librit E Diellja nder kisha të katundeve), të cillen i Ndritshmi Auktor mirsisht n’a dha lejen t’a shtypshim ktá, ásht një katekizem i vogel, qi permban shka do të besojë e shka do të shpresojë çdo nieri në ket jetë. Kanga e dytë ásht hymni i Papës Shëjt, e kndon madhni e lumni e t’âmbli Krisht në tokë.”

Të bën përshtypje përdorimi i foljes *na kande*, si të thuash një lloj lirie që kishte ai grup botuesish të librecit për të hequr e vënë në të, këngët që u pëlqenin.

Kënga e parë, si një këngë e marrë nga kisha të katundeve, e meriton të ketë një vend këtu:

Un prej Zotit³⁶

Un prej Zotit jam i kshtënë
E gjithmonë kshtû due me kêne
Qyshë m’atë ditë qi më kanë pagzue
Në kët Fé Shëjte jam i shkruë, e në ket Fé un due me rrnuë,
Kam me dekë e s’kam m’e lëshue
Pse e di mirë qi s’ka shëlbim
Per njata qi s’janë në kshtënim.

Çilci i gazmendit osë Fuqija e Uratës i shën Alfons de Liguorit, është libri i lutjeve që rezulton në listën e *Veprës Pijore*, n. 38. Libri ka 128 faqe, me formatin e një libri xhepi. Faqet e para fillojnë me “Të kushtuemit”, një hyrje që i drejtohet Zotit dhe sakrificave edhe më të mëdha që duhet të bëjë njeriu për t’u shëlbuar. Madje, përmes lutjeve thuhet, çdokush e ka në dorë “çilcin e të tana visareve”, por “për mos m’e lodhë vedin me të lutunat, dona vetë me metun shkret sikurse jena”³⁷. Në fjalët e tij te “Parathanie e Shëjtit

36 Po aty, ff.101-102.

37 *Çilci i gazmendit osë Fuqija e Uratës*, Shtypshkroja Zoja e Paperlyeme, Shkoder 1930, f. 5. Në hyrje theksohet se libri ka dy pjesë, ku në të parën do të flitet “per nevojë e per të vjeftun të lutunit”, ndërsa në të dytën do të flitet për hirin e të luturit që i jepet gjithkujt “me bisedue edhe mî mndyrë të zakonshme me të cilen punon hiri i Zotit”, por që pjesa

Alfons”, ndër të tjera lexojmë: “Unë kam qitë disa libra të pershshpirtshem, por kujtoi se s’kam bâ kurrnji punë mâ të vlefshme se ket liber, kû flas permî uratë...”.

Sipas *Diftojsit* libreci në fjalë ka këtë renditje:

Kreu I – Mi nevojën e të lutunit

- I. Të lutunit âsht i nevojshem doemos per m’u shëlbue;
- II. Pa urate nuk âsht e mundun me u qindrue tundimeve e me i majtë urdhnimet;
- III. Mi të lutuna qi u bâjnë Shêjtnave.

Kreu II – Mi dobin e të lutunit

- I. Sa punë e madhe âsht të lutunit e sa fuqi të madhe ka te Zoti;
- II. Fuqija e të lutunit kundra tundimeve;
- III. Zotyn âsht gjithmonë gadi me n ai ndigine të lutunat;
- IV. T’i lypim Zotit sende të mdhaja.

Kreu III – Mi qyshket e të lutunit

- I. M’u lutë per vedi;
- II. Me lypë sende të nevojshme per shëlbim të shpirtit;
- III. M’u lutë me pervûjtni;
- IV. M’u lutë me uzdaje;
- V. M’u lutë me qindrue.

Uratë të përditshme

- Uratët e nadjës;
- Uratët e ditës;
- Uratët e mrames;
- Gatim i shkurtë per rrfim ;
- Falenderje e shkurtë mas rrfimit;
- Gatim i shkurtë para Kungimit Shêjt;
- Falnderje e shkurtë mas Kungimit Shêjt;
- Urate e Atë Cukit me nxjerrë pastrin;
- Uratë që thohet para Krishtit të Kryqzuem;
- Kungim i pershshpirtshem;
- Anima Christi;
- Lëtenít e Zêmers së Jezu Krishtit;
- Misteret e Shêjtes Rruxare;
- Letenít e Virgjines Mrí.

Kreu I fillon me kritikë për ata “qi thojshin se urata nuk âsht e nevojshme”. Që në hyrje³⁸ hidhet ideja e rëndësisë së lutjes dhe punës që duhet bërë nga predikuesit e rrëfyesit pasi “pak i vên vesh me jau shtë në

e dytë, sipas një shënimi, nuk është përkthyer se “e ka bâ sidomos per me i dalë Zot Fës Shêjte kundra msimeve jansenistike qi ishin të perhapuna fort aso kohe e tesh janë fort të harrueme”.

38 Po aty, f. 7.

krye ket punë atyne qi i ndigiojnë predkat e tyne...” dhe shëlbimi “nuk mrinë pa e grishë Zotin”, pra pa lutje. Nëse dikush beson se Zoti i fal të gjithë, në libër theksohet se fal më shumë atë që e kërkojnë me lutje dhe “të dijsmit e Fës mâ të shumtit bashkë me Sh’ Bazilin, Sh’ Njon Gojartin, Klementin e Aleksandris, Sh’ Agostini e sa të tjerë”, theksojnë se urata për të rriturit është e duhura dhe pa i lypur “hired e nevojshme per m’u shëlbue, s’asht e mundun qi të shëlbohet”³⁹. Duke përdorur fjalët e Shën Agostinit “...tuj u lutë na, Zotyn na nep forcë me bâ çka s’jena të zott na vetë”, sqaron pamundësinë dhe pafuqinë e njeriut për t’i kundërshtuar tundimeve, por përmes lutjes merr forcë për të pranuar dobësitë dhe i identifikon ato; ky është një hap i madh.

Moji i qershorit josë *Moji i Zëmres T’ J. Krishtit*, qitun n’gjuhë shqipe prei P. Ënjell Sereqit i Shoqniis t’ Jezu⁴⁰ i përket Veprës Pijore n. 4 dhe përmban gjithsej 320 faqe.

Në këtë vëllim në secilën nga ditët e muajit qershor, flitet përmes lutjeve për Jezu Krishtin. Me një përkushtim, dashuri për të shkuar te zemra e tij, këndohet çdo lutje, sepse është mirësi, përvujtni, mëshirë, dashuri pa kushte, pastrim; sepse Ai është i butë, është dëgjues, durim, është ngushëllimi ynë, është streha jonë deri në vdekje. Lutja me titull “Kënduesit t’përkushtueshmit i zëmres t’Jezu Krishtit”, synon të shpjegojë se dashuria vjen dhe prej njohjes se “saa mâ fort t’njifet aq mâ fort i ngrehë t’gjitha zëmrat prej vedit”, si një “e mirë e pamarueme”, mbasi “kÿ t’njofun na e zgjâan prore t’kqyrunit t’onë n’ketë deet t’pamasë t’Lumniis t’vertetë...”.

Këto kujtime, urata “zhgjetore, lulze e ndollina qi gjinden n’ket liber mûnden me t’viefhtë, o këndues i perkushtueshem” jo veç në muajin qershor, por edhe në të tjera kohë të motmotit, siç shpjegohet në këtë libër formimi.

Libri është parë nga përkthyesi si një nevojë e domosdoshme për t’u përhapur sa më shpejt në duart e lexuesit dhe thekson se është mbështetur nga *Vepra Pijore* që e kanë botuar dhe e kanë shpërndarë te lexuesi me një çmim fare të ulët për të arritur kjo fjalë aty ku e ka drejtimin: zemra te zemra. Lutja për një besimtar mund të jetë lodhje, por jo vuajtje. Me shujtën në dorë, bëhet e qartë se kemi forcën dhe mbështetjen për mos ndjerë lodhjen, mbështetur te krahët e Aronit dhe Hurit (Dal. 17, 8-13) të cilët mbajnë duart e Moisiut që lutet për Izraelin.

Rrimë shtrëmtë e flasim ndrejtë është një liber apologije per gjithkend i shkruar nga Kolec Prennushi. Libri përmban 123 faqe dhe rreshtohet tek botimet e Veprës Pijore n. 40, botuar në vitin 1931 në Shkodër⁴¹. Bëhet fjalë për një mbrojtje e parimeve kristiane të vizionit të jetës. Në *Parafjalën* e tij, nënshkruar në Dajç më 14 Shtatuer 1931, autori nis me të mirat që

39 Po aty, f. 17.

40 *Moji i qershorit*, Vepra Pijore 4, Shtyp. e Zojës Paperlyme, Shkoder, 1911.

41 Shih: M. Peters, *vep. cit.*, f. 156.

ka fituar një vend prej mbylljes së kapitullit të historisë pesë shekullore dhe sjell idenë se tash nuk ka më nevojë për armë për ta fituar jetën dhe veten, por duhet të sundojë “fjala, idea, përparimi, armë më të fuqishme se të çeliktat, qi kalojnë ngadhnyeshëm mbî popuj tue mkamë e tue rroposë fronë”. Gjuha e autorit është disi e ashpër në këtë parafjalë si e quan ai, lidhur me zakonet e reja të të rinjve që i sheh si “Ndjeksë dhe apostuj të liberalizmit t’ indiferentizmit, t’ateizmit...” ku duket se në këtë kohë është “Ateizmi, hove-hove i shtëm deri në mni satanike kundra Hyjit...” Shqetësimi i tij është largimi i njeriut nga vlerat dhe burimet e vërteta të jetës duke u tërhequr nga argëtimi dhe nevojat materiale: “Sa më fort qi nieri kerkon me u vorrue në tokë aq ma larg i ikë lumniya.” Zgjidhje për autorin, e kësaj rropullie ndjesish të gabuara është “nji temel besimi të patundshëm e parime morale të kjarta, të ndrejta, të ngurrta pse çdo parim i gabuem të çon nji ditë ad absurdum.”

Duke dashur që t’i largohen “interesa-ve dhe knaqa-ve”, që e sheh te idetë liberale të përhapura ndër të rinj që studiojnë jashtë e vijnë me këto ide, autori mendon se: “Votra kulture mivjeçare rrokullisen e bijnë nën majin e liberal-radikalit, qí mbî gërmadhat e parimeve të moçme kremton triumfin e ides së liris. Gjaku i pafaj i atyne qi guxojnë t’ushqejnë tjera idé shkon rrëkajë nëpër rruga t’qytetit. E në këtë gjak ai njynë doren e vet trueshkyese e shkruem mbî flamur të ri:

Liberte, égalité, fraternité.

O kulture fetare, o bolshevizëm.”

Shpreh frikën e ardhjes së bolshevizmit rus, si një rrezik i madh për atë që mund të ndikonte te njeriu e te vendi ynë. Prennushi si një njohës i së vërtetës thotë: “Parimi i gabuem s’vonon me pjellë rrjedhimet e hatashme.”

Gjëja më e pëlqyeshme e këtij libri, është kërkimi dhe njohja e vetes si njeri. Shpesh kemi pyetje dhe si një Shën Agustin i mjerë nuk gjejmë ku t’i marrim ato përgjigje. Autori jo vetëm shqetësohet për atë që i ndodh njerëzimit, por ulet dhe mundohet të gjejë përgjigjet e tij për çdokënd që bën pyetje. A dimë në se ç’është besimi? A e pranojmë lehtësisht atë si të vërtetë apo thjesht e mendojmë si mënyrë për të gënjer veten në këtë jetë? Prennushi të tregon për punë të besimit duke i dhënë përgjigje pyetjeve apo dyshimeve që i vijnë ndokujt. Nuk “lufton” me arsyetimet e tij të të mbushë mendjen, pasi besimi vetëm këtë nuk e do, por gjithsesi mundohet të gjejë përgjigje për ato mendje që luftojnë vazhdimisht me veten. Po sjellim njërin nga pikat ku parashtrohet mendimi i dikujt e më pas sqarohet me përgjigjen nga autori:

Mendimi: 7. *Besimi â gjâ e errtë.*

Une besoj çka të më provohet kjartë e çiltas. Çka nuk shof me sý nuk besoj.

Përgjigjja: *Çka nuk shef ti nuk beson? A e shef ti menden t’adne? Jo! Don me thanë prá qi s’ke aspak.*

Përveç përgjigjes me fjalë nga ungjilli, shprehet thjesht edhe me këtë shembull që e sollëm më lart. Në mbrojtjen e tij, Prennushi thekson lidhjen e fortë që ka dija me besimin, me fjalët e Pasteur i njohur edhe si një besimtar katolik i devotshëm: “Mu pse kam xanë me temel, jam fëtar si një katundár Breton”.

Shpesh përpigemi të flasim për lirinë e të japim ide mbi këtë koncept. Nga nxitimi i dëshirës së madhe për të, gabojmë dhe abuzojmë rreth këtij koncepti kaq të bukur. Nga një shembull i marrë në këtë libër apologjije rreth idesë së lirisë së njeriut, të bën përshtypje forca e mendimit dhe e besimit të autorit. Në asnjë moment ai nuk shket në argumente për këdo që beson apo jo. Ai thotë: “Kur Thiers vjetin 1849 foli në parlament mbî lirin e msimit, një deputet ia preu fjalën tue thanë se Kisha ishte kundërshtarja e lirisë mendimit, d.m.th. i dogmit themelues të shoqnis moderne. Thiers ia ktheu: *Unë levdohem se jam i shoqnis moderne, kam studjue edhe shumë mbî të quejtunen liri mendimi; e une kam gjetë se besimi pengon në mendime vetun ata qi nuk dijnë me mendue* (Le jeune Apologiste, f. 62)”.

Në vitet 1931-1932 kjo vepër ka marrë vlerësime të veçanta nga redaksia e revistës *Leka* si vepër e vlefshme për nga lënda apo nga *Lajmëtari i Zëmërs së Krishtit* që fton lexuesit e krishterë ta blejnë këtë libër⁴².

Shtypja e fjalës shqip

Vepra Pijore ka një vlerë jo vetëm në pikëpamje të letërsisë, por mbi të gjitha të gjuhës, siç e kemi thënë që fillim të materialit. Gjuha e përdorur në këto libra, romane, drama, kalendarë e librecë është e bukur dhe e pasuruar në vazhdimësi.

Procesi i nxitur nga Rilindja Kombëtare për pasurimin e fjalëve të gjuhës shqipe dhe pastrimin e tyre, ka qenë i gjatë dhe i vështirë. Përgjatë viteve 1902-1905 Atë Françesko Gjenovici S.J., së bashku me Atë Anton Xanonin, u kujdesuan për një gjuhë shqipe të pastruar nga turqizmat. Ky i fundit ndër të tjera, bëri përpjekje që të shmangë çdo fjalë të huazuar jo vetëm nga turqishtja, por edhe “nga italishtja, ose sllavishtja dhe t’i zëvendësojë ato me rrënjë të vjetra shqip” si një punë hyrëse “për të gjitha rregullat retorike e stilistike të gjuhës dhe të shkrimit shqip”, që do të vijonte nga “Át Giuseppe Valentini SJ (1900-1979) me botime të ndryshme në revistën *Leka* të viteve 1930”⁴³. Atë Jáq Jungg-u⁴⁴, mësues në Kolegjin e Shën Françes Saverit, “kuvendonte përzemërsisht me popullin” duke e zhvilluar më tej e vazhdimisht gjuhën shqipe (përmes veprimtarisë së tij

42 M. Peters, *vep. cit.*, f. 157.

43 M. Peters, *Át Anton Maria Xanoni sj – jeta dhe vepra e tij për Rilindjen Kombëtare*, në *Hylli i Dritës*, n. 3, 2007, f. 85.

44 Prift, shkrimtar dhe predikues, themelues i “Kongregacionit të Zojës Nunciatë”, njëri prej themeluesve dhe redaktori i parë i revistës *Lajmtari i Zëmërs së Krishtit*.

letrare dhe pedagogjike), duke e bërë dhe vehten e tij një prej “shkrimtarëve dhe ndihmësve më të çmueshëm të gjuhës sonë”⁴⁵. Atë Anton Xanoni mbliidhte me kujdes të palodhur fjalët e reja e të panjohura në qytetin e Shkodrës e me to krijonte “mas natyret t’ morfologiis shqyptare njetó fjalë qi i derdheshin per me prehë sêndet e reja a mândimet e nelta qi giûha populllore nuk kaa se si i qet”⁴⁶. Në nder të punës së tij prej atdhetari e gjuhëtari i kushtohen vargje nga Atë Gjergj Fishta (*Mii vorr t’A. Anton M. Xanonit S.J.*): “Qi t’msheftat fije giûhës sqyptare i lype,/ E i gjete e i ênde, e neper dhâmza t’dijes/ me shûm hollië i pershkove e raven çile,/ Kahë Shqyptari do t’majë per me stolisun/ Fjalën, e shllimet per me i shprehë per s’marit.”

Në *Veprën Pijore*, n. 1, në fund të saj, autori Kolë Thaçi, vendos një fjalor fjalësh të zorshme, që shpjegohen në fund të librit dhe “...28 prej tyre nuk gjenden te “Fialuer i Rii i Schypès” i 9 janarit 1908 i botuar nga shoqëria “Bashkimi” në Shkodër. Ato janë pronë e *thesaurus*-it aktiv personal të Kolë Thaçit, që ai i vë në shërbim të përdorimit masiv popullor⁴⁷:

1. Ahmarrje - t’ marrunit e gjakut e t’ uhàs.
2. Aht - t’ hjekun, fshamë.
3. Brue - kerkues.
4. Burrojë - balcue.
5. Dermue (m’ u) - m’ u ulë.
6. Dermore - hov.
7. Dindë (me) - me çue peshë.
8. Ferfelitë (me) - me shndritë.
9. Galdim - gzim i math.
10. Gnjye (me) - me trathtue.
11. Gorromisë (me) - me pshtjellë.
12. Harë - shënd.
13. Lartsue (me) - me neltue.
14. Lipsi - dhimë.
15. Ngallnì - çelèng, lumnì.
16. Nojmë - diftim.
17. Perbindsh - mahlukat.
18. Pervarsë - fèlshues.
19. Polem - popull.
20. Sodak - kurban.
21. Strokull - shpellë.

45 M. Peters, *At Jak Jungg, themelues dhe nestor i albanologjisë shkodrane*, në *Hylli i Dritës*, n. 3-4, 2013, f. 269.

46 E përkohshmja *Perparimi* në vitin 1915, në numrin e tretë të saj, i kushton një shkrim jetës dhe veprimtarisë të Atë Ndoc M. Xanonit.

47 A. Çapaliku, *vep. cit.*, ff. 127-128.

22. Shkerbàe - përbindsh.
23. Shkerbaltë - shmije. (Shmije – shemti, shën. A. Çapalikut).
24. Terrtim - idhnim.
25. Tranditë (me) - m' u tundë, m' u trand.
26. Tutundzë - t' rrahunit e zëmres.
27. Vezullue (me) - me shndritë.
28. Vrenue (me) - me caktue."

Rëndësia dhe vlera e këtyre përpjekjeve dokumentohet sot, pasi kur rihidheshin dokumentet shqip, i ribotonin "njashtë si ishin, tue ruejtë jo vetëm fjalët, por edhe orthografin edhe pikëzimin original, me gjith gabimet qi mund të shumoheshin n'ato provë të para, për shumkend, të shkrimit në gjuhë amtare...."⁴⁸, si një mundësi për ta parë nga afër atë ndryshim.

Një tjetër përpjekje e mundimshme ishte dhe çështja e vendosjes së alfabetit të gjuhës shqipe. Vendosja e alfabetit të Kongresit të Manastirit, lidhet pak a shumë me kohën e botimeve të para të *Veprës Pijore*. Diskutimet e vazhdueshme mbi shkronjat e përdorura te revista *Albania* e Konicës, jepen me një paraqitje të alfabetit që "Albania é ka per te perdorur me numer 8 é tutjë"⁴⁹ dhe paraqet si shkronja të përdorura më parë: a, b, d, dh, e, é, f, g, gh, h, i, j, k, l, m, n, ń, o, p, r, s, sh, t, th, u, y, v, z, dz. Ndryshojnë sipas revistës shkronjat: ts (tsapi), ch (chika), ll (ylli), c (curra), rr (rreth), zh (zhaba).

Kalendari i shoqnisë "Dija", në numrin e parë për çështjen e alfabetit të shqipes shprehet për mungesën e bashkimit të shqiptarëve në lidhje me alfabetin, pasi "té kemi kater Alfabéta, kan me ken édhé kater mênên é kater xêmra"⁵⁰ Në f. 4 të këtij kalendari, jepet edhe alfabeti i shqipes me gërmat e përbashkëta e ato të ndryshme.

Alfabétat e Gégevét

Te pergithchimé jane: a, b, d, f, g, h, i, k, l, m, n, o, p, r, s, t, u, y, v;

Keto te tiérat jane shkaku i luftes (kupto debateve për miratimin):

Bashkimi	Agimi	Bashkimi	Agimi
ts	c	ets, tsopë	ec, copë
é, e	e	férre, ets	feía, ec
e	ə	émen	emən
gh	ǵ	ghak	ǵak

48 Leka, 1940 (XII), numër i vetëm, f. 5.

49 Shih revistën *Albania*, 1901.

50 Kalendari i shoqnisë "Dija", nga shtypshkronja "Mbrothësia", Kristo Luarasi, në Sofia, 1906 (shkruhet në kalendarin e 1906-ës Šoknisë "Dija" për vjtën 1906). Šoknisë "Dija" për vjtën 1906, f. 3.

i,j	i	xiar, jam	zjar, jam
c	ċ	café	ċafə
ll	l	mole	mołə
gn	ġ	gni	ġi
rr	ř	rrush	řuř
sh	š	shosha	šoša
th	þ	thike	þikə
x	z	xêmer	zêmer
xh	ž	xhghéte	žgetə
z	dz	zîna	dzîna

Për punë të alfabetit të përdorur, ende pa u pranuar mirë *alfabeti* i ri dhe i ndryshuar i Shoqërisë *Bashkimi* (alfabeti i sotëm i shqipes) përmes një zgjidhjeje të mesme të Kongresit të Manastirit, Xanoni e sjell atë menjëherë midis nxënësve të tij duke botuar në vitin 1909 gramatikën e parë të gjuhës shqipe, pikërisht me këtë alfabet të sotëm.⁵¹ Po ashtu, dy veprat e para të *Veprës Pijore* të vitit 1909 “qenë të parat vepra në trojet shqiptare që u botuan me alfabetin e ri”⁵². Tragjedia e Shenjt Eustakit,⁵³ si vepra e parë e botuar nga *Shoqata*, në hyrje të saj ka shënime për shkronjat që janë përdorur, dhënë në dy kolona:

Alfabeti i moçem	alfabeti i ri
c (caa)	ç
c (canner)	q
gh	g
g	gj
gn	nj
g (gakue)	xh etj.,

duke rregulluar disa nga shkronjat dyshe në gjuhën tonë si: *nj, xh, zh, th, dh, ll* apo edhe *c, x, z, y...*, që janë përmirësuar në alfabet nga grafemat dikur. Po aty sqarohet se *shkronja ë (e pazë) akoma nuk mund të jetë tash për tash në shtypshkronjë dhe përdoret e në vend të saj*. Nuk përdoren zanoret dyshe për ta theksuar atë, por përdoren zanoret hundore: â, ê, á, é, è, ó, í, ú.

Iniciativa e jezuitëve për t’iu bashkuar vendimit të Kongresit të Manastirit

51 M. Peters, *Át Anton Maria Xanoni...*, *Hylli i Dritës*, n. 3, 2007, ff. 82-83.

52 Po aty, f. 125.

53 *Sh’ Eustaki o Familia e martirve*, tragjedi me pes hova, Shtypshkroje t’Paperlyemes, Shkodër 1909. Përkthyer nga italishtja prej Kol Thaçit, mësues në kolegjin e Sh. Francesk Saverit.

dokumentohet te revista *Leka*, 1940 (XII), numër i vetëm⁵⁴, nëpërmjet një përgjigjeje të Atë Pasit në italisht, Klubit “Bashkimi” të Manastirit. Aty thuhet se do të pranojnë atë alfabet që do të vendosë Kongresi dhe po në atë faqe, aprovohet si një shënim poshtë fletës se si “Elçija” edhe Shtypshkronja e Zojës, ishin më të parët që përdorën këtë alfabet.

Në një material te kalendari i 1918-ës, jepet një shpjegim se si janë ndjekur rregullat e drejtshkrimit sipas Komisionit letrar të Shkodrës, dhe theksohet se janë shmangur diku për ndonjë shkronjë që nuk e kanë në shtypshkronjë, p.sh. nga mungesa e í-së me theks, është përdorur ii (dy i) për të treguar gjatësinë e zanores. Disa shembuj të përdorimit të zanores së theksuar, përmes përsëritjes mund t’i rendisim, marrë nga drama e *Fernandit*⁵⁵: *tyy; maa; seli; saa fort kee ndrrue; kuer leen i kthielltë; t’paamit e tii; nuk i kaa mbetë; t’rii për të rinj; do t’ keen mbrritë; dhe për dhë; m’jee; gjaall; udhtim kaq t’mûndshem e t’duhiishem; lajmtaar; sÿy; ndeerat; nierziin; me naam; mirsiin; me zâa t’ultë; diiti; miksii; shoqnûi; me raa me fjelt; qelii; me hûi; paash; bâamirsat* etj.

Në kalendarin e vitit 1921 theksohet se tashmë ekziston mundësia e shkrimit grafik me theks të fortë apo të butë, të zanoreve, përtej atyre hundore, duke shmangur përdorimin e përsëritjes së zanoreve.

Në kalendarin e vitit 1924, diskutohet standardizimi i shkrimit të fjalëve⁵⁶, por mbi të gjitha kërkohet nga dijetarët të merren vesh “a do të ndjekim nder shkrime systemin fonologjik, si shkrimtarët e Jugosllavisë e t’Italisë, pse â shumë më i shpejtë e i simplert edhe për shkollat fillore, ase systemin filologjik, qi shpesh herna të bân me i shkruar fjalët në një mënyrë e me këndue në një tjetër, e t’a ndalon edhe shpejtimin e të shkruarit?”. Problemi i shkrimit të fjalëve ndryshe nga kjo anë, nuk tregon pasuri gjuhë, por “pabashkim qi edhe në lamë t’ortografis mretton neper Tosk’ e neper

54 Shih: *Leka*, 1940 (XII), numër i vetëm, f. 8. Nga jezuiti Atë Dedë Pasi, sillen vendimet e një komisioni jezuitësh mbi përdorimin e alfabetit të “Agimit” 2 qershor 1908 ku ndër të tjera thuhet: “...për me ndrrue alfabetin e “Elçis” (“Elçija i Zëmeres së Jezu Krishtit, botohej atëherë me alfabetin e vjetër shkodran) për të marrë atë t’ “Agimit”. Tash për tash nuk e shifshim të volitshme, por se, kur të bashkohen Bashkimi me Agimin, ose Agimi me Toskët, na do t’i mirrshim mbrapa. Por Imzoti (Imz. Lazer Mjeda) na u lut qi nemose të bájshim për të botime me germa t’Agimit, sikursë kishim bân për Abatin (për Timz. Dochin, kryetarin e “Bashkimit”, për të cillin Shypshkroja e Jezuitvet shtypi Fjalorin e përmendun); aj kishte për të na gjetë gerrat e nevojshme. Tue e pasë qitë punën në kshillë me Konsultorët e zakonshëm e me At Genovizzi (At Frano Genovizzi, jezuit, mbas At Pasit qe mandej për shumë vjet kryepar i Misjonit Shetitës Shqiptar të jezuitvet e qyshë atëherë shumë punonte për “Elçin e botimet tjera të jezuitvet) të gjithë mendojnë se s bân me e këputë për jo, pse Imz. Mjeda e âna e ti do ta mirrshin për të keq. Sâ për gerrat lë t’i blejë Imz. Mjeda, por shtypshkroja kâ me ja pague atë pak ka pak me punimet qi kâ me bân për Agimin.”

55 *Bardhi e Fernandi tu vorri i Karlit IV. Duka i Agrixhentit*, dramë me pes hova, 1910.

56 Shih për shembull: *vjershë dhe jo vjerrshë, letratyrë dhe jo literatyrë* etj.

Gegë". Lidhur me standardizimin e fjalëve diskutohet vendosja ose jo e ë-së së pazëshme që pa kurrfarë nevojë shkon "tuj të shtrengue me i pikue të tana fjalët"⁵⁷.

Në kalendarin e 1927-ës ka edhe një faqe në fund të ndreqjes së gabimeve duke shtuar këtë rubrikë në funksion të përmirësimit të shërbimit ndaj fjalës.

Përkthimi i veprave në shqip dhe përpjekjet për unifikimin e shqipes, kur dihen vështirësitë e asaj periudhe, është një nga kontributet më të mëdha që po i bëhej vendit dhe gjuhës së tij.

Si u mbajt në këmbë kjo Vepër?

Një nga çështjet e rëndësishme të programit të *Veprës Pijore*, është donacioni apo bamirësia për të botuar veprat e saj. Te pika 4 e programit, kategorizohen grupimet e bamirësisë në tri klasa dhe emërtohen bamirësit në "Shok themelues" apo "Shok Ndimtaar". Këto të ardhura në mënyrë kategorike do të përdoreshin vetëm për qëllimet e *Veprës Pijore* dhe madje "per sigurtii e dobiei maa t'madhe kto pare vendoseshin në një bankë për transparencë. Një arkëtar e një sekretar për çdo muaj, bënte një analizë të gjendjes ekonomike të *Veprës* dhe veprimet e tyre kontrolloheshin nga drejtori i *Veprës Pijore*. Për punën e mirë që bënë etërit jezuitë *bâmirsat shkodranë i patne besim të madh kësai organizate sa me i pshtetë shum shpesh zbatimin e bâmirsinave të veta dhe kjo duket dhe nga shuma e mbledhur nga bamirësitë që kaluan nëpër duart e *Veprës Pijore* "në mâ se 2600 frang, si kâ kënë frangu n'atë kohë"⁵⁸.*

Vepra Pijore lulëzoi si vepër kulturore e si vepër "bâmirëse, sa qi muji të shpenxojë mâ se 13 mijë grosh në bâmirsí, e 38 mijë grosh e 26 mijë koronë në mâ se 30 botime"⁵⁹. Jetoi e punoi *Vepra Pijore* "vetun me dhunti e t'faluna t'atyne Shqyphtarve t'vertetë qi tuj dashtë t'miren e vëndit e t'mkamunin e lulzimin e letratyres lidhen vullndetarisht me i perkrahun krye vjetit me do pare per t'shtypun t'librave t'ri"⁶⁰. Me programin e saj ajo u bë edhe mbështetëse e *Elçisë*: "Vepra Pijore ja kaa vûu vedit detyren me pague krye vjetit shka t'jeet mangut n't'shitun t'Elciis a t'Lajmtarit t'Zëmers s'Krishtit".

Me rastin e 30-vjetorit të krijimit të *Veprës Pijore*, në revistën *Leka* do të bëhej një vlerësim edhe për gjithë ata që kontribuan me bamirësinë e tyre,

57 *Kalendari Vietar*, 1924, f. 86.

58 *Veprimi i Veprës Pijore – Vargu i botimeve*, në *Leka*, nr. 6, 1937, ff. 268-270.

59 "Shoqninat Giûhsore të Rilindjes; XXX vjetori i "Veprës Pijore", në *Leka*, n. 5, 1937, f. 233.

60 Tek "Lajmëtari i Zemres s'J. Krishtit" i marsit të vitit 1916, gjejmë një shënim për nder të 25-vjetorit të revistës, f. 57.

duke u përmendur këtú si “bâmirsat mâ të mëdhajt”⁶¹ apo edhe si anëtarë të rregullt të *Veprës Pijore*.⁶² Po në atë shkrim, theksohet se burimet, “posë një ndime 4000 liresh italyane që fali Ministria e Financave”, qenë gjithmonë vetëm “lëmshët e antarvet, të hîmet e shitjes së librave e ato të shfaqeve teatrale të dhânuna prej antarësh për ndimë të Vepres.” E në vijim është dhënë një “pasqyrë të jetës financiare t’organizatës”⁶³.

Bashkëpunimi midis botimeve të etërve jezuitë, dilte në pah edhe me vlerësime të botimeve të *Veprës* herë pas herë në revistën *Lajmtari i zemrës s’Jezu Krishtit* apo edhe *Përparimi*. Ja disa prej tyre:

1. Në fund të revistës *Lajmtari i zemrës s’Jezu Krishtit* (vjeta XXV, n. 1, kallndori 1915, f. 17), reklamohen dy botime të *Veprës Pijore*:
 - *Kalendari 1915* me N. 13 ku thuhet se “Ky liber me 72 faqe t’mdhaja âsht plot me kallxime t’kandshme e t’dobiishme. T’gjith shqyptarët kan për t’a kndue me t’knaqun t’zêmres. E hijeshojn edhe 16 fugura t’vogla e t’mdhaja.”
 - *Pushka e trathtarit* e Zot. Zef Harapi (1891 – 1946). Shkruhet në kopertinë: *Pushka e trathtarit*, Vepra Pijore Nr. 14). Âsht një romanz 200 faqesh fort i bukur. E kaa shkruar Zot. Zef Harapi Shkodranë, bashkë me shumë t’ndolluna t’jetës s’onë komtare pershinë e paraqet edhe kallxime tjera që t’bâjn me njoftë shumë maa teper zakonet, dheshkrojen e historiën e Shqypniis s’onë.”
2. *Kalendari i madh i 1918 i Veprës Pijore*; lajmërohet dalja e tij te *Lajmëtari* i vitit 1917 (Vj. XXVII, n. 2).
3. Viti 1919, Vj. XXIX, N. 4, i *Lajmëtari* jep njoftim për Veprën Pijore *Shyhyret i divoçem, e katerta dorë*”.

61 Revista “Leka”, nr. 6 1937, f. 270: *Balto Shiroka që lla një shpî, Zoja e quejtun Kusha e Vogel që fali 1010 fr. si vitalic, Z. Ndoc Çoba, Imz. Mjedja, Imz. Serreqi, Atë Genovizzi, Z. Gjon Shiroka që perkëthei “Detyrat e Trimit” e hoq vetë shpenximet e botimit, Z. Çija e Gjin Dajçit që mbledhte ndima ndër Zeja Shkodrane, Z. Shan Koliqi, Z. Kolë Ujka, Z. Pjerin Simoni, e sâ e sâ tjerë të pasun edhe të vorfen, posë gjith atyne që e mbajten emnin e vet të mbështetun.*

62 “Antare të rregullshëm të Vepres, që paguejshin një taksë kohë mbas kohe kjene: Meshtarit ZZ. D. Luigi Bumçi, D. Pjeter Dëma, D. Simon Gjokiçi, D. Zef Gjonali, D. Gjergj Haberi, D. Nikoll Hajmeli, D. Prend Kalori, D. Nikoll Kimëza, D. Gjokë Kukulla, D. Ndrë Lisna, D. Zef Naraçi, D. Mark Negri, D. Ndrë Plani, D. Zef Qafalija, D. Nikoll Radovani, D. Ndrë Simoni, Atë Rektori i Jezuitvet; ZZ. Loro Ashiku, Simo Berdica, Ndoc Bushati, Kolë Çeka, Gjon Çoba, Ndoci i G. Dëmës, Gasper Doda, Pjeter Dodmasej, Shan Koliqi, Gasper Krraqi, Mati Laca, Zefi i Pjeter Llopit, Kolë Nika, Pjeter Nonaj, Kolë Pistulli, Pjerin Simoni, Gasper Tusha, Kolë Thaçi, Kolë Ujka, Loro Zadrime, Romolo Zamputti; Zojat Lezja e Shan Preçit, Dani Êjell Serreqi, Terezinë Ujka, e tjerë që mbajten mbshehë emnin e vet”, shih: *Leka*, nr. 6, 1937, ff. 268-270.

63 Në revistën *Leka*, nr. 6, 1937, jepet një tabelë transparence e llogarive të të ardhurave të hyra e të dala për botimin e *Veprës Pijore* në vitet 1907-1925, f. 271.

4. Viti 1921 N. 2, Vj. XXXI i *Lajmëtari* sjell informacion për *Kalendarin e Vjetës 1921* me shënimin "i denjë për t'u rreshtuar ndër libra" si dhe botimet e *Veprës Pijore* me n. 1, 3, 11, 14, 15, 16, 17, 20.
5. Viti 1925 Vj. XXIX, N. 1 i *Lajmëtari* flet për *Kalendarin e vjetës 1925* që shitet në Shtypshkronjën e Jezuitëve dhe veçon materialet e rëndësishme e të pabotuara më parë në lëmë të historisë së Shqipërisë.
6. *Përparimi*, n. 6, 1916, në kopertinën e fundit të tij, reklamon botimet e *Veprës Pijore: Kalendarin i v. 1915, Pushka e Trathtarit, Dyy Pasqyra, Gjenovefja e Brabantit, Kalendari i v. 1916, Joana D'Ark*.
7. Gjithashtu *Përparimi* (janar 1915), jep disa vlerësime për botimin e *Kalendarit 1915*, nga Arqipeshkvi i Shkupit, Lazër Mjeda; prej Prizrenit dhe po aty, uron botimin e këtij *Kalendari*, Imzot Bernardin Shllaku, *Vesc. di Pulati* (në italisht) prej Gjânit, ndërsa Imzot Primus Doçi, abat i Mirditës, përveç botimeve, uron punën e *Veprës Pijore*, për të mirë të fesë e të atdheut. Në këtë revistë për të bërë të njohur vlerën e librit *Pushka e Trathtarit*, botohet dhe një vlerësim prej Gomsiqet nga At. Sh. Gjeçovi.

Vepra Pijore, Elçija e Zembrës së Krishtit më pas e quajtur *Lajmëtari i Zembrës së Krishtit*, *Leka* janë produkte me vlerë që kanë dhënë një kontribut të madh në edukimin e vlerave të rinjtë dhe tërë shoqëria e kohës. Në 50-vjetorin e Kolegjës Saveriane, krijohet shoqata L.E.K.A. (Lidhja, Edukata, Kultura, Argëtimi) me qëllim lidhjen vëllazërore, edukimin përmes leximeve të vlefshme, kulturën me botime të ndryshme e argëtimin me teatro, muzikë e sport⁶⁴.

Përfundime

Përmes këtij punimi donim të nxirrnim disi në dritë atë punë të devotshme e madhore që kanë bërë këta njerëz me shpirt të madh e sakrifikues. Themelimi i shoqatës *Vepra Pijore* u bë si një organ nxitës, për të gjetur hapësirën për të botuar shkrimet e përkthimet e tyre emra të mëdhenj të letërsisë shqipe e botërore. Brenda 38 viteve të aktivitetit të saj (1908-1946), u botuan 44 vepra me përmbajtje të ndryshme, 16 prej të cilëve kalendarë, *kallxime* origjinale, argëtuese, përkthime si: drama e romane, novela, jetëshkrime, shujta.

Kontributi i shoqatës *Vepra Pijore* solli në vatrat e mijëra shqiptarëve gjuhën shqipe, poezinë, njohuritë mbi historinë, besimin, kishën, pavarësisht gjithë atyre pështjellimeve që hera-herës trazonin Shqipërinë. Letërsia që ata botonin, lidhej me fenë, por edhe edukonte vlerat të

64 *Leka*, vjeta 1, numër i veçantë, Organi i Shoqatës L.E.K.A., Shkodër, prill 1929, ff. 1-6.

lexuesi. Synimi i saj ishte që përmes botimeve të ndihmonin në orientimin pedagogjiko-didaktik të të rinjve, por edhe shkollave në përgjithësi. Detyra e tyre ishte zgjimi shpirtëror e kulturor i të rinjve në radhë të parë, por edhe tërë popullatës. Përkthimi i dramave bëri që teatri të shndërrohej në një mjet pedagogjik që i shërbente formimit të shoqërisë së asaj kohe, nëpërmjet argëtimit.

Shoqata *Vepra Pijore* me punën e etërve jezuitë, hodhi bazat e një gjuhe letrare të pasur në fjalë e në shprehje. Dëshira e tyre ishte të ndihmonin në ngulitjen e përdorimin e një gjuhe shqipe sa më të unifikuar e të pastër nga fjalët e huaja që e kishin bombarduar në shekuj. Këto libra do t'i shtoheshin letërsisë sonë në fushën e përkthimit dhe do të përcillej përmes tyre gjuha shqipe të lexuesi. Nga ana tjetër kërkonin të përhapnin dijen, se vetëm përmes saj, vendi do të përparonte.

Tërë puna e *Veprës Pijore* ishte një kërkim ndriçues i historisë së vendit tonë që dilte pa asnjë plaçkë trashëguese nga nënshtrimi otoman. Duhet të punohej për zbulimin e asaj që ishte e fjetur nën pluhur për shekuj. Rëndësia e formimit të përgjithshëm të popullit me informacione (Kalendarët) të ndryshme nga historia e vendit, dokumentimi i kësaj, jeta e figurave të rëndësishme të historisë vendase e botërore, rreziqet nga botëkuptime të ndryshme, tema të shkencave të natyrës si: zoologjia, astronomi, po ashtu nga filozofia historia fotografia etj., u bënë themeli kryesor që gjeti përkrahës dhe lexues.

Programi i *Veprës Pijore*, tregon më së miri seriozitetin e saj. Ajo i shkon për shtat sot revistave më të mira të kohës sonë, ku botohet çdo shkrim sipas një rregulli dhe rëndësisë së shkrimit. Çështja e gjuhës shqipe dhe shkollave shqipe, ishte një nga pikat më të rëndësishme të çdo shqiptari me ndjeshmërinë e duhur ndaj vendit. Këtë gjë drejtuesit e shoqatës së *Veprës Pijore*, e bënë me devocion e atdhetari.